



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Drejtuar: Operatori ekonomik PAB Tirana shpk
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.6, Rruga e Kavajës, Prona Nr.2/66, ish Kombinati Ushqimor, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Referenca e procedurës: REF-66013-07-20-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shporta e bebes”

Kohëzgjatja e kontratës: Një vit duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

Fondi limit: 13.455.000 (trembëdhjetë milion e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa tvsh

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 14.06.2019 ora 11.00

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini 44 datë 27 Korrik 2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik Spar Albania shpk NUIS L51603008A

Nuk ka paraqitur ofertën ekonomike në përputhje me Shtojcën 1 të DST.

2. Operatori ekonomik Eurolab Internacional Grup shpk NUIS K36503231E

Vlera e ofertës pa TVSH- 35.820.000 (tridhjetë e pesë milion e tetëqind e njëzetë mijë) leke

Vlera e ofertës me TVSH- 42.984.000 (dyzetë e dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë

3. Operatori ekonomik PAB Tirana shpk NUIS L81829016P

Vlera e ofertës pa TVSH- 36.375.000 (tridhjetë e gjashtë milion e treqind shtatëdhjetë e pesë

mijë) leke

Vlera e ofertës me TVSH- 43.650.000 (dyzetë e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- | | |
|--|------------------------|
| 1. Operatori ekonomik Eurolab Internacional Grup shpk | NUIS K36503231E |
| 2. Operatori ekonomik Spar Albania shpk | NUIS L51603008A |

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria Spar Albania shpk nuk është paraqitur në datën dhe orën e caktuar nga AK për paraqitjen e mostrave.

2. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë hapjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga kjo shoqëri konstatoi se Operatori ekonomik Spar Albania shpk nuk ka paraqitur në spe (sistemin elektronik) dokumentacionin ligjor, teknik dhe atë ekonomik c'ka e bën ofertën e tyre të pavlefshme.

3. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë hapjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga kjo shoqëri konstatoi se Operatori ekonomik Spar Albania shpk nuk ka paraqitur në spe (sistemin elektronik) ofertën ekonomike në përputhje me Shtojcën 1 të DST, c'ka e bën ofertën e tyre të pavlefshme. Nuk ka paraqitur ne ofertën ekonomike vlerën totale të ofertuar pa dhe me tvsh.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit

2. Oferta e paraqitur nga **Operatori ekonomik Eurolab Internacional Grup shpk**

Vlera e ofertës pa TVSH- 35.820.000 (tridhjetë e pesë milion e tetëqind e njëzetë mijë) leke

Vlera e ofertës me TVSH- 42.984.000 (dyzetë e dy milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë) lekë

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë hapjes dhe shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga OE Eurolab Internacional Grup shpk konstatoi se:

1. Operatori ekonomik Eurolab Internacional Grup shpk, nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë të përcaktuar në DST, sipas pikës 2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2019 dhe 2020 sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” (i ndryshuar). Operatori ekonomik Eurolab Internacional Grup shpk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vendet ku ushtron aktivitet për periudhën 2020, por jo për periudhën 2019.

2. Operatori ekonomik Eurolab Internacional Grup shpk, nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë të përcaktuar në DST, sipas pikës 2.3 Kapaciteti teknik: 2.3.1 Dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, me vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet, ose 14.997.600 (katërmëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.

Dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të realizuara gjatë tri viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit të paraqitura nga Operatori ekonomik Eurolab Internacional Grup shpk nuk janë në përputhje me objektin e prokurimit.

3. Operatori ekonomik Eurolab Internacional Grup shpk, nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar në DST, sipas pikës 2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim të lëshuar nga Prodhuesi ose Distributori i Autorizuar (ku të provohet/ dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) nëpërmjet të cilit autorizohet të tregëtojë artikujt/ produktet objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i vlefshëm për të gjithë periudhën e kontratës. *Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana jonë.*

4. Operatori ekonomik Eurolab Internacional Grup shpk në përputhje me pikën 2.3.4 *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit mostra për cdo artikull të kërkuar në preventiv. Mostrat/ produktet objekt prokurimi duhet të paraqiten/ prezantohen të amablazhuara në formën e “Shportës së bebes” me produktet/ artikujt që do të përmbajë. Mosparaqitja e mostrave dhe prezantimit të përcaktuar sa më sipër është kusht për skualifikim”,* ka paraqitur pranë AK ditën e hapjes dhe dorëzimit të ofertave Mostrat/ produktet objekt prokurimi. Pas fazes së dorëzimit, KVO u mblodh për shqyrtimin e specifikimeve teknike për cdo mostër të paraqitur nga ana e shoqërisë sa më sipër cituar, nga ku rezultoi se disa prej artikujve të dorëzuar nga OE nuk përmbushin specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 të DST.

- Artikulli “Letër e lagur për bebe”, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 të DST, pasi letra e lagur e dorëzuar nga OE nuk është për pastrimin e pjesëve intime dhe jo intime të bebes, nuk ka përmbajtje pambuku, etj.

- Artikulli “Krem hidratues për bebe me vitamina”, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 të DST, pasi kremi hidratues i dorëzuar nga OE përmban parfum apo ngjyruar në përbërjen e tij, nuk përmban Vitamine E dhe Vaj bajamesh ose vaj orizi ose Gjalp (shea) etj.

- Artikulli “Vaj hidratues trupi për bebe”, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 të DST, pasi vaji i trupit për bebe i dorëzuar nga OE nuk është në sasinë 200 ml -250 ml.

- Artikulli “Pelena një përdorimshe për bebe masa 1”, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 të DST, pasi Pelena një përdorimshe të dorëzuar nga OE nuk është e masës 1.

- Artikulli “Shishe qelqi me Biberon”, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 të DST. Biberoni për bebe i dorëzuar nga OE është qelqi por nuk përmbush asnjë specifikim tjetër të përcaktuar në DST.

- Artikulli “Biberon fallco”, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 të DST. Biberoni fallco i dorëzuar nga OE nuk është i përshtatshëm për fëmijët e moshave mbi 0 muajsh (0 muaj +), Biberoni nuk është i hollë dhe fleksibël për gojën e bebes, etj.

- Artikulli “Lodër pellush”, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 të DST. Lodra pellush e dorëzuar nga OE nuk është e përshtatshme për fëmijët 0-3 muaj, nuk përmban certifikimin OEKO-TEX etj.

- Artikulli “Libër bebe”, nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara në shtojcën 10 të DST. Lodra pellush e dorëzuar nga OE nuk është një botim i përshtatur me informacione të vlefshme për kujdesin ndaj fëmijës në vitet e para të jetës së fëmijës.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik PAB Tirana shpk, me adresë: Njësia Bashkiake Nr.6, Rruga e Kavajës, Prona Nr.2/66, ish Kombinati Ushqimor, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 36.375.000 (tridhjetë e gjashtë milion e treqind shtatëdhjetë e pesë mijë) leke pa tvsh dhe 43.650.000 (dyzetë e tre milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet sic parashikon Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 14.08.2020

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, nuk është paraqitur asnjë ankesë.